



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority
Nr. i Post./Nr. Prot./Prot. No. 38/25-M/D
Nr. i Fq./Nr. St./No. Fq. 1/4
Data/Date/Date: 20. 01. 2025

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Vendimi Nr. K-03/25
Datë: 20.01.2025

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkatës. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e datës 00 .10.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. Lejohet Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e të gjithë kapitalit aksionar nga Proex Sh.p.k., (blerës) mbi VRJ Sh.p.k., (targeti).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 08.07.2024, me Nr. Prot. 433/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e të gjithë kapitalit aksionar nga Proex Sh.p.k., mbi VRJ Sh.p.k.

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 26.09.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 01.10.2024
3. Marrëveshja/Kontrata e Shitblerjes e të gjithë kapitalit aksionar të emetuar të VRJ Sh.p.k., lidhur me datë 1 Shkurt 2024.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i së paku dy pjesëmarrësve në Përqendrim e kalon shumë 3,000,000 Euro.
2. Marrëveshja/Kontrata e Shitblerjes e të gjithë kapitalit aksionar të emetuar të VRJ SH.P.K., lidhur me datë 1 Shkurt 2024.

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, i paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11,13,17,18 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2023 neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

Palët në transaksion:

Proex sh.p.k., (blerësi), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, me seli në Rr. "Fehmi Lladrovci" numër 32 (Hipermarket InterEx), 10000 Prishtinë, e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) me numër unik identifikues (NUI) 810806862. Proex sh.p.k., është një kompani private Kosovare me fushëveprim në territorin e Republikës së Kosovës e cila merret me tregtinë me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani" si dhe aktivitete të tjera të natyrës së tillë. Blerësi është në pronësi të CDI -Kosovo L.L.C., me 100% të aksioneve. CDI -Kosovo L.L.C., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 810802183, me adresë në Rr.Fehmi Lladrovci 32(Hipermarket InterEx), e cila merret me; Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e mallrave ushqimore, pijeve dhe duhan.

VRJ SH.P.K., (targeti), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, me seli në adresën Rr. "Dëshmorët e Gollakut", Lagjja Marigona Hill, 10000 Prishtinë, e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) me numër unik identifikues (NUI) 812063965. VRJ sh.p.k., zotëron 100% të aksioneve në shoqërinë Jeta sh.p.k., me numër unik identifikues (NUI) 811981415, kompani e cila ka të drejtat në koncesion sipas kontratës së Koncesionit për " Ndërtimin e garazheve publike pranë QKUK-së në Prishtinë sipas projektit zbatues të Komunës së Prishtinës" me Komunën e Prishtinës.

Tregu përkatës;

Tregu i produktit: Tregu i qiradhënies dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira, blerja dhe shitja e patundshmërisë personale, zhvillimi i projekteve të ndërtimit etj.

Tregu gjeografik:, tregu përkatës gjeografik përkufizohet *territori i Republikës së Kosovës.*

Analiza e konkurrencës:

Transaksioni i propozuar nuk paraqet shqetësim për çështje të konkurrencës në tregun e Republikës së Kosovës, pasi që, nuk ka mbivendosje të produkteve mes shoqërive të përfshira në transaksion. Në aspektin krahasimor gama e produkteve të secilës palë në përqendrim të cilat do të mund të

konsiderohen me karakteristika të përbashkëta, rezulton të jetë zero. Tregu ku Blerësi operon është tregu i shitjes me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron, ushqimi, pijet, frutat dhe perimet, duhani, etj. Në bazë të analizës së strukturës së tregut. Blerësi ka 7-10 % pjesëmarrje në tregun e shitjes me pakicë të produkteve kryesisht ushqimore në tregu përkatës, pra tregu për ofrimin e shitjeve me pakicë – supermarkeve në Republikën e Kosovës është treg mjaftë konkurrues pasi ka një numër të madh të kompanive që kanë rrjete të supermaketeve në tërë Republikën e Kosovës dhe më gjerë. Ndërsa, tregu ku Shoqëria Target operon, është ai qiradhënies dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira, blerja dhe shitja e patundshmërisë personale, zhvillimi i projekteve të ndërtimit etj.

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura për faktit se shoqëritë e përfshira operojnë kryesisht në sektorë të ndryshëm dhe kombinimi i aktiviteteve nuk do të çojë në një pozicion dominues në treg për asnjë nga linjat e produkteve të përfshira. Transaksioni si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, andaj, tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Duke pasur parasysh se blerësi dhe targeti nuk janë aktiv në treg të njëjtë të produktit, pra nuk ka mbivendosje të aktiviteteve të palëve në Kosovë në tregun përkatës kemi të bëjë me një përqendrim konglomerat. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Bazuar në sa më sipër, rezulton se transaksioni i propozuar nuk do të ndikojë në konkurrencën në Kosovë dhe se është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Autoriteti, me marrjen e njoftimit të plotë të përqendrimit, në përputhje me nenin 17 paragrafi 3 në paragrafi 3.4, ka publikuar në ueb faqen e vet njoftimin publik, për përqendrimin e synuar, i cili është obliguar të qëndroj 15 ditë, (<https://ak.rks-gov.net>), lidhur me parashtrimin e vërejtjeve, komenteve, në mënyrë që të dhënat e mbledhura të kontribuojnë në sqarimin, pra në kuptim, të marrëdhënies dhe situatës në tregjet përkatëse. Autoriteti, nuk ka pranuar asnjë reagim, nga palët e interesuara.

Shënim:


Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva